FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 160

Tiranë – E hënë, 5 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 1.12.2022	Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore.....	19025
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 1.12.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i nënstacionit 400 kv Elbasan 3".....	19027
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 1.12.2022	Për mënyrën e ngritjes dhe funksionimit të sistemit elektronik të regjistrimit dhe raportimit të aktivitetit të peshkimit dhe përcaktimin e kohës për vënien në funksion të tij.....	19031
Udhëzim ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 631, datë 21.11.2022	Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët 6–15 vjeç.....	19036
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim nr. 734/6, datë 1.12.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim i bllokut të banesave të kufizuar nga bulevardi 'Çamëria', rruga 'Pelivan Leskaj', rruga 'Piro Sava' dhe rruga 'Kujtim Beqiri'".....	19048

VENDIM
Nr. 748, datë 1.12.2022

PËR PËRCAKTIMIN E ZONËS, DISTANCËS DHE GJERËSISË SË BRIGJEVE TË BURIMEVE UJORE

Në mbështetje të shkronjës "dh", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është:

a) përcaktimi i zonës, distancës dhe gjerësisë së bregut të burimit ujor, bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, të parashikuara në këtë vendim, konkretisht të:

i. brigjeve përgjatë detit;

ii. brigjeve në liqene, rezervuarë natyrorë apo artificialë, laguna, pellgje me ujë, duke përfshirë këtu liqenet, rezervuarët ujorë, natyrorë apo artificialë;

iii. brigjeve përgjatë lumenjve dhe përrenjve;

iv. brigjeve përgjatë kanaleve artificiale.

b) përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për ndjekjen e procedurave për miratimin e hartave të brigjeve.

2. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **"Gjerësi e bregut"**, gjerësia e hapësirës tokësore nga brinja e sipërme e shtratit të burimit ujor në drejtim të tokës.

b) "**Seksion i sistemuar"**, ajo pjesë e një trupi ujor në të cilin janë kryer ndërhyrje infrastrukturore hidroteknike të nevojshme për sistemimin e ujërave natyrore ose artificiale, si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, me veshje dhe/ose riprofilim të ndryshëm nga gjendja natyrore e cila siguron kalimin e prurjes maksimale të llogaritur.

c) "**Shtrati i burimit ujor**", terreni natyror ose artificial, nëpër të cilin, përherë apo përkohësisht, rrjedh ose qëndron uji.

ç) "**Vijë bregdetare**" ose "**vija e bregdetit**", vija që formon kufirin midis bregdetit (tokës) dhe zonës së bregut.

d) "**Vijë ujore**" ose "**vijë e bregut të trupit ujor**", kufiri ujë-tokë.

dh) **"Zonë e bregut të burimit ujor"**, hapësira tokësore nga brinja e sipërme e shtratit të burimit ujor që shtrihet në drejtim të tokës, sipas gjerësisë së përcaktuar në bazë të kritereve të përgjithshme e të posaçme.

e) "**Zona e bregut të detit**", hapësira që krijohet ndërmjet kufirit ujë-tokë, i cili referuar vendimit nr. 1018, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri-tema: detet", është niveli i ujit të detit në baticë dhe vijës bregdetare dhe ku çdo ekosistem bregdetar natyror përfshihet në këtë hapësirë.

II. KRITERET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E ZONËS, DISTANCËS DHE GJERËSISË SË BREGUT TË BURIMIT UJOR

3. Zona, distanca dhe gjerësia e bregut të burimit ujor përcaktohet në bazë të këtyre kritereve të përgjithshme, si më poshtë vijon:

a) tipologjisë së burimit ujor (i rrjedhshëm apo i qëndrueshëm);

b) ruajtjes së ekosistemeve;

c) sigurimit të vazhdimësisë së rrjedhës së trupave ujorë gjatë prurjeve maksimale;

ç) mbrojtjes nga uji;

d) morfologjisë së brigjeve;

dh) deluvioneve dhe aluvioneve të depozituara në vite përgjatë burimit ujor;

e) pjerrësisë së shtratit të burimit ujor;

ë) pjerrësisë së brigjeve;

f) infrastrukturës së transportit rrugor, hekurudhor dhe ujitjes e kullimit, argjinaturat dhe veprat mbrojtëse, portet, të cilat kanë ndryshuar rrënjësisht karakterin e bregut në krahasim me atë natyror;

g) dokumenteve të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

gj) garantimit të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës së bregut të burimeve ujore në harmoni me nevojat për zhvillim urban, si dhe me veprimtaritë ekonomike, sociale e turistike që zhvillohen ose kanë ndikim mbi të.

III. KRITERET E POSAÇME PËR PËRCAKTIMIN E ZONËS, DISTANCËS DHE GJERËSISË SË BREGUT SIPAS LLOJEVE TË BURIMEVE UJORE

4. Vija bregdetare shënohet me fillimin e bimësisë së përhershme ose kur ka një ndryshim të dukshëm në morfologjinë e nënshtresave ose

formës së tokës, p.sh. nga një plazh relativisht i sheshtë në duna kodrinore, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) kur në zonën e bregut të detit ka seksione të sistemuara, janë ngritur objekte publike të infrastrukturës së transportit, si rrugë, shëtitore etj., apo të infrastrukturës së mbrojtjes përgjatë bregut nga proceset natyrore detare, vija bregdetare është kufiri i shtrirjes së veprës publike në drejtim të detit;

b) në rastin e porteve detare, zona e bregut të detit konsiderohet territori i tij sipas planeve të përgjithshme vendore (PPV) ose planeve të detajuara për zonat me rëndësi kombëtare (PDZRK) ose vendimeve të KKT-së për shpalljen e zonave të rëndësisë kombëtare, të miratuara sipas përcaktimeve në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

c) në rastet kur PPV-të dhe PDZRK-të, të miratuara sipas përcaktimeve në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, kanë përcaktuar vijën kufi deri ku lejohet zhvillimi i territorit dhe kjo vijë përkon me kriteret e vijës bregdetare sipas këtij vendimi, atëherë ajo vijë do të konsiderohet kufiri i zonës së bregut të detit në drejtim të tokës, përveç seksioneve të sistemuara, për të cilat zbatohen parashikimet e shkronjës "a", të kësaj pike. Në të kundërt, PPV-të apo PDZRK-të i nënshtrohen rishikimit në ato territore ku vija nuk përkon me kriteret e vijës bregdetare;

ç) në rastet kur në PPV-të apo PDZRK-të nuk parashikohen zhvillime në zonën e bregut të detit dhe kjo krijon mundësinë e zbatimit të nenit 8, të ligjit nr. 10234, datë 18.2.2010, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin "Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe" të Konventës së Barcelonës "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut", atëherë zona e bregut të detit do të jetë jo më pak se 100 metra në gjerësi;

d) në rastin e brigjeve shkëmbore të thepisura, me pjerrësi të konsiderueshme më shumë se 70°, që përfundojnë drejtpërdrejt në sipërfaqen e detit, sipërfaqja e shpatit të pjerrët së bashku me zonën e sipërme përtej shpatit në drejtim të tokës, e cila është e ndikuar nga proceset bregdetare, konsiderohet zonë e bregut të detit;

dh) kur vija kufi e bregut të detit përkon me kufirin natyror të lagunës, zona, distanca dhe gjerësia e bregut detar është dinamike dhe ndjek ndryshimin e regjimit të kufirit të lagunës. Në këtë rast toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit konsiderohet si zonë e bregut të detit;

e) në rastin e deltave të lumenjve, limaneve detare dhe ngushticave, si pjesë e ujërave të brendshme detare, vija bregdetare i nënshtrohet kushteve dhe kritereve për zonën e bregut të detit.

5. Në liqene, rezervuarë, pellgje me ujë, natyrorë apo artificialë, laguna, zona dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore e krijuar nga vija ujore tek vija e krijuar nga gjurma e lënë nga uji në vite gjatë niveleve maksimale, në të gjithë perimetrin e trupit ujor, duke krijuar aluvione apo zona të pagjelbëruara me bimësinë karakteristike të përhershme të brezit të tokës, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) në rastin kur në zonën e bregut të këtyre trupave ujorë ka seksione të sistemuara, ku janë ngritur objekte publike të infrastrukturës së transportit, si rrugë, shëtitore etj. apo të infrastrukturës së mbrojtjes nga proceset natyrore, zona dhe gjerësia e bregut ka kufi kufirin e shtrirjes së veprës publike në drejtim të trupit ujor;

b) në rastet kur PPV-të apo PDZRK-të, të miratuara sipas përcaktimeve në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, kanë përcaktuar vijën kufi deri ku lejohet zhvillimi i territorit dhe kjo vijë përkon me kriteret e zonës, distancës dhe gjerësisë së bregut, atëherë ajo vijë do të konsiderohet kufiri i zonës së bregut në drejtim të tokës, përveç seksioneve të sistemuara, për të cilat zbatohen parashikimet e shkronjës "a", të kësaj pike. Në të kundërt, PPV-të apo PDZRK-të i nënshtrohen rishikimit të plotë ose të pjesshëm në ato territore ku vija nuk përkon me kriteret e vijës së bregut për këta trupa ujorë;

c) në rastin e rezervuarëve artificialë të ujitjes, si nivel maksimal i gjurmës konsiderohet niveli apo perimetri maksimal, që përcaktohet në projektin e ndërtimit të rezervuarit, si dhe kushtëzimet në projekt, nëse ka të tilla, mbi këtë nivel maksimal.

6. Zona, distanca dhe gjerësia e bregut përgjatë lumenjve dhe përrenjve përcaktohen, si më poshtë vijon:

a) në lumenjtë apo përrenjtë ku pjerrësia e profilit gjatësor të shtratit është më e madhe se 10%, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është nga vija ujore deri në vijën e krijuar nga gjurma

maksimale e ujit për prurje me probabilitet 1 herë në 100 vjet (P=1%);

b) në lumenjtë apo përrenjtë ku pjerrësia e profilit gjatësor të shtratit është më e madhe se 4% deri në 10%, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është 5m për pjerrësinë 4% dhe 2m për pjerrësinë 10% në plan, nga vija ujore deri në vijën e krijuar nga gjurma maksimale e ujit, sipas prurjes mesatare shumëvjeçare. Për vlera të ndërmjetme, përllogaritja bëhet nëpërmjet procesit matematikor të nxjerrjes së vlerave të ndërmjetme kundrejt dy vlerave të njohura (*interpolim linear*);

c) në lumenjtë apo përrenjtë ku pjerrësia e profilit gjatësor të shtratit është 2% deri 4%, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është 25m për pjerrësinë 2% dhe 5m për pjerrësinë 4% në plan nga vija ujore deri në vijën e krijuar nga gjurma maksimale e ujit, sipas prurjes mesatare shumëvjeçare. Për vlera të ndërmjetme, përllogaritja bëhet nëpërmjet procesit matematikor të nxjerrjes së vlerave të ndërmjetme kundrejt dy vlerave të njohura (*interpolim linear*);

ç) në lumenjtë e përrenjtë ku pjerrësia e profilit gjatësor të shtratit është më e vogël se 2%, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është 100m për pjerrësinë 0% dhe 25m në plan për pjerrësinë 2%, nga vija ujore deri në vijën e krijuar nga gjurma maksimale e ujit, sipas prurjes mesatare shumëvjeçare. Për vlera të ndërmjetme, përllogaritja bëhet nëpërmjet procesit matematikor të nxjerrjes së vlerave të ndërmjetme kundrejt dy vlerave të njohura (*interpolim linear*);

d) në lumenjtë e përrenjtë që kalojnë brenda zonave të urbanizuara, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore që formohet ndërmjet nivelit maksimal të ujit të seksionit tërthor dhe veprave publike apo atyre që janë në përputhje me dokumentet e planifikimit vendor, të miratuara;

dh) në lumenjtë e përrenjtë, shtretërit dhe/ose brigjet e të cilëve janë mbrojtur me argjinaturë dhe/ose strukturë gjatësore e tërthore mbrojtëse apo kanë seksione të sistemuara, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore me ose pa ujë që krijohet ndërmjet argjinaturave, strukturave mbrojtëse, seksioneve të sistemuara dhe vijës ujore.

7. Në kanalet artificiale, zona, distanca dhe gjerësia e bregut është hapësira që krijohet nga vija ujore deri në kuotën e sipërme të skarpatës së kanalit. Në rastet kur ka PPV të miratuara, sipas përcaktimeve në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, zona dhe gjerësia e bregut është sipas përcaktimeve të planit.

8. Për raste të veçanta të papërcaktuara më sipër apo që rezultojnë nga ndërthurje të parashikimeve të sipërpërmendura, janë organet e menaxhimit të burimeve ujore që interpretojnë zonën, distancën dhe gjerësinë e bregut.

IV. DISPOZITA KALIMTARE

9. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për ndjekjen e procedurave për përcaktimin e hartave të brigjeve dhe miratimin, rast pas rasti, në KKU dhe KKT.

10. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit e njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 749, datë 1.12.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kv ELBASAN 3"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i nënstacionit 400 kv Elbasan 3".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 13 475 622 (trembëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 13 475 622 (trembëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekësh, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., për pasuritë e shpronësuara.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I "NËNSTACIONIT 400 kv ELBASAN 3"

Nr.	Pronësia										Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale e pronës m²	Sip. e pronës që shpronësohet m²	Çmimi i shpronësimit në lekë/m²	Vlera e shpronësimit lekë/arë	
Bashkia Elbasan											
Fshati Kryezjarrth											
1	Feim Avdul Zeneli & Alie Begdash Zeneli			2296	44/1/3	arë	2500	2,500	222	**555,000**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
2	Mirela	Preni	Merdani (Çakalli)	2296	44/1/4	arë	2000	2,000	222	**444,000**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
3	Nosi	Vasil	Biba	2296	44/2	arë	4000	4,000	222	**888,000**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
4	Englantina	Josif	Ranxha	2296	44/3/1	arë	1625	1,625	222	**360,750**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
5	Kozeta	Josif	Kuqi	2296	44/3/2	arë	1625	1,625	222	**360,750**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
6	Ndriçim	Marthe	Tollumi	2296	44/4	arë	3792	3,792	222	**841,824**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
7	File	Tasi	Zela	2296	44/5	arë	2831	2,831	222	**628,482**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Feride	Dylber	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Ervin	Jani	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Mirjan	Jani	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Aferdita	Vasil	Sollaku								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Dhimiter	Vasil	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Vangjeli	Vasil	Xhija								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Jani	Vasil	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
8	Dhimiter	Vasil	Zela	2296	44/6	arë	2700	2,700	222	**599,400**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
9	Thoma	Ili	Bica	2296	45/2/1	arë	2900	2,900	222	**643,800**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
10	Jorgji	Tasi	Bica	2296	45/3	arë	2750	2,750	222	**610,500**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
11	Foti		Ranxha	2296	45/4	arë	4125	4,125	222	**915,750**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
12	Thoma	Spiro	Roçi	2296	45/7	arë	3539	3,539	222	**785,658**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Afërdita	Grigor	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Gentian	Thoma	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Alfred	Thoma	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan

	Eduard	Thoma	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Ervin	Thoma	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
13	Kostandin	Simon	Drizari	2296	45/8	arë	5000	5,000	222	**1,110,000**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
14	Petrit	Grigor	Drizari	2296	45/9	arë	2500	2,500	222	**555,000**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
15	Ligor	Simon	Drizari	2296	45/10	arë	810	810	222	**179,820**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
16	Agim	Jakov	Tollumi	2296	45/11	arë	2715	2,715	222	**602,730**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
17	Nikolla	Vasil	Biba	2296	45/12	arë	1570	1,570	222	**348,540**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
18	Aleks	Vasil	Biba	2296	45/13	arë	5500	5,500	222	**1,221,000**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
19	Dafina	Merkur	Biba	2296	45/14	arë	2375	2,375	222	**527,250**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Aldi	Bashkim	Biba								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Bashkim	Vasil	Biba								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Prene	Petrit	Biba								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Aleks	Vasil	Biba								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Nosi	Vasil	Biba								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Nikolla	Vasil	Biba								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Bukuri	Vasil	Shqau								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
20	Gezim Naun Shati & Bukurie Peter Shati			2296	45/15	arë	1625	1,625	222	**360,750**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
21	Eduard	Jorgji	Oga	2296	45/1/3	arë	2000	2,000	222	**444,000**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
22	Eduard	Jorgji	Oga	2296	45/1/4	arë	2219	2,219	222	**492,618**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
Sipërfaqe totale shpronësimi m²								**60,701.00**			
Vlera totale e shpronësimit										**13,475,622.00**	

VENDIM
Nr. 756, datë 1.12.2022

PËR MËNYRËN E NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT ELEKTRONIK TË REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË AKTIVITETIT TË PESHKIMIT DHE PËRCAKTIMIN E KOHËS PËR VËNIEN NË FUNKSION TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 77, pika 3, dhe 85, pika 2, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim ka si objekt ngritjen e Sistemit të Raportimit Elektronik të të Dhënave (ERS) në peshkim, si një bazë të dhënash që regjistron, raporton, përpunon, ruan dhe transmeton të dhënat e peshkimit (zënie, zbarkim dhe transbordim), sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

Neni 2
Qëllimi

Regjistrimi dhe raportimi elektronik i të dhënave të peshkimit ka për qëllim të forcojë efektivitetin e operacioneve të monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, si në det, ashtu edhe në tokë.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Anije dhënëse**", gjatë aktivitetit të transbordimit është anija, e cila i kalon produktet peshkore anijes pritëse.

2. "**Anije pritëse**", gjatë aktivitetit të transbordimit është anija, së cilës i kalohen produktet peshkore nga anija dhënëse.

3. "ERS", Sistemi i Raportimit Elektronik, është komunikimi elektronik i të dhënave të aktivitetit të peshkimit nëpërmjet:

a) përbërësve kompjuterikë *(hardware dhe software);*

b) tërësisë së rregullave që sigurojnë funksionimin e tij.

4. "**Informacionet e librit të anijes**", informacioni sipas pikës 37, të kreut IV, të vendimit të kontrollit.

5. "**Kodi alfa 3 të FAO**", kodi i specieve sipas shtojcës 3, të vendimit të kontrollit.

6. "**Korrigjime lehtësisht të identifikueshme**", ndryshime që dallohen lehtë nga autoritetet kompetente.

7. "Ligji i peshkimit", ligji nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

8. "MTU *(Mobile Transcevier Unit)",* pajisjet e miratuara nga ministria përgjegjëse për peshkimin, të vendosura në bordin e anijeve të peshkimit sipas pikës 33, të kreut IV, të vendimit të kontrollit.

9. "**Numri i jashtëm i identifikimit**", anijet e peshkimit shënjohen sipas rregullave të parashikuara në kreun III, të vendimit të kontrollit.

10. "Operacion peshkimi", çdo aktivitet që lidhet me kërkimin e peshkut, tërheqjen, hedhjen dhe rikuperimin e një vegle peshkimi, si dhe me grumbullimin e zënieve nga vegla e peshkimit.

11. "Vendimi i kontrollit", vendimi nr. 407, datë 8.5.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim", i ndryshuar.

12. **"XML (*extensible mark-up language)",*** gjuhë kompjuterike e cila bazohet në formatin tekst për organizimin e informacioneve.

Neni 4
Institucioni administrues i ERS-së

Të dhënat e gjeneruara nga Sistemi i Raportimit Elektronik administrohen nga ministria përgjegjëse për peshkimin.

Neni 5
Të dhënat parësore dhe dytësore

Baza e të dhënave që krijohet nga sistemi ERS përmban:

a) të dhënat parësore sipas shtojcave 4 dhe 5, të vendimit të kontrollit;

b) të dhëna dytësore sipas pikës 24, të kreut IV, të vendimit të kontrollit.

Neni 6
Dhënësi i informacionit

Çdo kapiten, pronar ose përfaqësues i anijes së peshkimit, me një gjatësi të përgjithshme të barabartë ose më të madhe se 12 metra, detyrohet të regjistrojë dhe të transmetojë librin e anijes së peshkimit, deklaratat e zbarkimit dhe të dhënat e transbordimit në mënyrë elektronike, nëpërmjet sistemit ERS.

Neni 7
Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave

ERS-ja ndërvepron me Sistemin e Vëzhgimit të Anijeve (SVA), duke përdorur MTU-në e këtij sistemi, si pjesë të tij.

Neni 8
Niveli i aksesit

Kapitenët e anijeve të peshkimit kanë akses të sigurt, të identifikueshëm me përdorues dhe fjalëkalim, 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, në të dhënat e librit të tyre elektronik të anijes së ruajtur në bazën e të dhënave.

Neni 9
Baza e raportimit të të dhënave

Raportimi i të dhënave për zëniet nëpërmjet sistemit ERS bazohet në librin elektronik të anijes së peshkimit, i cili përdoret për të regjistruar dhe transmetuar në mënyrë të sigurt detajet e operacioneve të peshkimit.

Neni 10
Raportimi i informacionit

Informacioni menaxhohet nga kapiteni i anijes së peshkimit dhe u transmetohet autoriteteve të përcaktuara në këtë vendim, ku të dhënat autentike të operacionit të peshkimit ruhen në një bazë të sigurt të dhënash.

Neni 11
Detyrimi i regjistrimit dhe i raportimit

Me ngritjen dhe funksionimin e sistemit ERS, që anija e peshkimit të ushtrojë aktivitetin e peshkimit, kapiteni i anijes së peshkimit detyrohet të regjistrojë dhe të komunikojë menjëherë informacionin në lidhje me aktivitetet e peshkimit, duke përfshirë zbarkimet dhe transferimet, si dhe t'u vendosë në dispozicion autoriteteve të përcaktuara në ligjin e peshkimit një kopje të këtyre të dhënave.

II. PLOTËSIMI DHE TRANSMETIMI ELEKTRONIK I TË DHËNAVE

Neni 12
Raportimi i të dhënave për zëniet

Kapitenët e anijeve të peshkimit, me gjatësi totale të barabartë ose më të madhe se 12 metra, regjistrojnë elektronikisht informacionet e librit të anijes dhe i transmetojnë në rrugë elektronike në QNOD dhe në institucionin përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës, së paku një herë në 24 orë:

a) me kërkesë të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës;

b) menjëherë pas përfundimit të operacionit të fundit të peshkimit;

c) përpara hyrjes në port;

ç) në momentin e çdo inspektimi në det;

d) në rrethana të veçanta të përcaktuara nga legjislacioni i peshkimit.

Neni 13
Detyrimi i raportimit në transbordim

Në zbatim të neneve 85 dhe 99 të ligjit të peshkimit, kapitenët e anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 12 metra, të përfshira në një veprimtari transbordimi, plotësojnë një deklaratë transbordimi, duke raportuar sasinë për çdo specie të dhënë ose të pritur, në rastin kur kjo sasi është mbi 50 kg peshë e gjallë.

Neni 14
Plotësimi i deklaratës së transbordimit

Deklarata e transbordimit, e përmendur në nenin 13, të këtij vendimi, duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) Numrin e jashtëm të identifikimit dhe emrin e anijeve të peshkimit, dhënëse dhe pritëse;

b) Kodin alfa 3 të FAO-s për çdo specie dhe zonën gjeografike në të cilën janë bërë zëniet;

c) Vlerësimet e sasive të secilës specie të shprehura në kilogramë, të ndara sipas llojit të prezantimit të produktit ose, sipas rastit, numrit të individëve;

ç) Portin e mbërritjes së anijes pritëse të peshkimit;

d) Portin e caktuar për transbordimin.

Neni 15
Toleranca në përllogaritje

Toleranca e lejuar në përllogaritjet e sasive në kilogramë të peshkut të dhënë ose pritur, regjistruar në deklaratën e transbordimit, është 10% për të gjitha llojet.

Neni 16
Raportimi i transbordimit në format letër

Deri në vënien në funksion të sistemit ERS, kapiteni i anijes dhënëse dhe kapiteni i anijes pritëse duhet të paraqesin secili një deklaratë të transbordimit në format letër, në një kohë sa më të shpejtë dhe në çdo rast jo më vonë se 48 orë pas transbordimit:

a) pranë QNOD-së dhe institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës;

b) nëse transferimi ka ndodhur në portin e një shteti tjetër, tek autoritetet kompetente të shtetit të portit në fjalë.

Neni 17
Përgjegjësia mbi të dhënat

Kapiteni i anijes dhënëse dhe kapiteni i anijes pritëse janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave të raportuara në deklaratën e transbordimit.

Neni 18
Raportimi elektronik i deklaratës së transbordimit

Kapitenët e anijeve të peshkimit, me një gjatësi të përgjithshme të barabartë ose më të madhe se 12 metra, të përfshira në një operacion transbordimi, regjistrojnë në mënyrë elektronike informacionin e përmendur në nenin 14, të këtij vendimi, dhe ia transmetojnë atë në mënyrë elektronike QNOD-së dhe institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga përfundimi i operacionit të transbordimit.

Neni 19
Marrja e raportimit

QNOD-ja dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës pranojnë raportet elektronike, që përmbajnë të dhënat e anijeve të peshkimit, sipas nenit 14 të këtij vendimi.

Neni 20
Transbordimi nga një anije e huaj

Nëse një anije peshkimi e huaj transbordon zëniet e saj në Shqipëri, QNOD-ja dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës i transmetojnë menjëherë elektronikisht të dhënat nga deklarata e transbordimit tek autoritetet kompetente të shtetit flamur të anijes së huaj, si dhe tek autoritetet kompetente të shtetit në të cilin zëniet janë të destinuara.

Neni 21
Plotësimi i deklaratës së zbarkimit

Në zbatim të nenit 82 të ligjit të peshkimit, në informacionin që përmban deklarata e zbarkimit përfshihen:

a) numri i jashtëm i identifikimit dhe emri i anijes së peshkimit;

b) kodi alfa 3 i FAO-s për çdo specie dhe zona gjeografike në të cilën janë bërë zëniet;

c) sasitë e secilës specie në kilogramë, të ndara sipas llojit të prezantimit të produktit ose, sipas rastit, numrit të individëve;

ç) porti i zbarkimit.

Neni 22
Detyrimi i raportimit të zbarkimit

Kapiteni i një anijeje peshkimi me gjatësi të përgjithshme të barabartë ose më të madhe se 12 metra ose përfaqësuesi i tij regjistron në mënyrë elektronike informacionin e përmendur në nenin 21 të këtij vendimi, dhe ia transmeton atë në mënyrë elektronike QNOD-së dhe institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës sapo të jetë plotësuar dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga përfundimi i operacionit të zbarkimit.

Neni 23
Transmetimi i korrigjimeve

Kapiteni mund të transmetojë korrigjime në librin elektronik të anijes dhe në deklaratën e transbordimit përpara hyrjes në port. Korrigjimet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme. Të gjitha të dhënat origjinale të librit elektronik dhe korrigjimet e tyre duhet të ruhen nga QNOD-ja dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës.

Neni 24
Ruajtja e informacionit nga kapiteni i anijes

Kapiteni ruan në format elektronik një kopje të informacionit të përmendur në nenin 12, të këtij vendimi, në bordin e anijes së peshkimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së udhëtimit të peshkimit deri në paraqitjen e deklaratës së zbarkimit.

Neni 25
Dhënia e konfirmimit

QNOD-ja siguron që një mesazh marrjeje t'u dërgohet anijeve të peshkimit pas çdo transmetimi të të dhënave të librit të anijes, transbordimit ose zbarkimit. Ky mesazh përfshin një konfirmim të marrjes së informacionit.

Neni 26
Njoftimi para hyrjes në port

Në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 10/2017, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për masat e shteteve portuale për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar", kapitenët e anijeve të peshkimit transmetojnë në mënyrë elektronike në QNOD njoftimin paraprak për hyrjen në port.

Neni 27
Komunikimi me shtetin e flamurit

Nëse një anije e huaj synon të hyjë në një port shqiptar, QNOD-ja, pasi ka marrë njoftimin paraprak të përmendur në nenin 26 të këtij vendimi, do t'ua transmetojë atë menjëherë, në mënyrë elektronike, autoriteteve kompetente të shtetit të flamurit.

III. FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË REGJISTRIMIT DHE TË TRANSMETIMIT TË TË DHËNAVE ELEKTRONIKE

Neni 28
Raportimi në rast dështimi teknik

Në rast të një dështimi teknik ose mosfunksionimi të sistemit elektronik të regjistrimit dhe të transmetimit të të dhënave, kapiteni, pronari i anijes ose përfaqësuesi i tyre i autorizuar, komunikon (në telefon ose në radio) të dhënat përkatëse të librit të anijes, të deklaratës së zbarkimit dhe të dhënat e transbordimit në QNOD, çdo ditë dhe jo më vonë se ora 24:00, edhe në mungesë të zënieve:

a) me kërkesë të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës;

b) menjëherë pas përfundimit të operacionit të fundit të peshkimit;

c) përpara hyrjes në port;

d) në momentin e çdo inspektimi në det;

e) në rrethana të veçanta të përcaktuara nga legjislacioni i peshkimit.

Neni 29
Përditësimi i të dhënave

QNOD-ja përditëson librin elektronik të anijes pas marrjes së të dhënave të përmendura në nenin 28 të këtij vendimi.

Neni 30
Masat në rast të dështimit teknik

Një anije peshkimi nuk largohet nga porti, në rast të një dështimi teknik ose mosfunksionimit të sistemit elektronik të regjistrimit dhe transmetimit të të dhënave, përpara se institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës të ketë konstatuar se sistemi funksionon normalisht ose kur anija është autorizuar të lundrojë nga ky institucion.

Neni 31
Mosraportimi i të dhënave

Kur QNOD-ja dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës nuk kanë marrë të dhënat e transmetuara, në përputhje me nenet 12, 18 dhe 22 të këtij vendimi, oficerët e shërbimit të peshkimit në sallën operacionale në QNOD informojnë menjëherë kapitenin ose pronarin e anijes ose përfaqësuesin e tyre. Nëse për një anije të caktuar kjo situatë ndodh më shumë se tri herë brenda një viti, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës siguron që të kryhet një kontroll në sistemin e tij elektronik të transmetimit. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës kryen hetime për të përcaktuar shkaqet e mosmarrjes së të dhënave.

Neni 32
Ruajtja e të dhënave nga autoritetet

QNOD-ja dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës ruajnë bazat e të dhënave për funksionimin e sistemeve të tyre elektronike të transmetimit. Këto baza të dhënash përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

a) listën e anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, të cilat kanë pësuar një defekt ose dështim teknik në sistemet elektronike të transmetimit të të dhënave;

b) numrin e transmetimeve të librit elektronik të anijes së pranuar çdo ditë dhe numrin mesatar të transmetimeve të marra për çdo anije;

c) numrin e deklaratave të zbarkimit dhe transbordimit të marrë.

IV. SHKËMBIMI I TË DHËNAVE DHE QASJA NË TË DHËNAT

Neni 33
Komunikimi me shtetet e tjera

Shkëmbimi i informacionit me shtetet e tjera kryhet sipas modelit *ad hoc*, bazuar në formatin në XML *(extensible mark-up language)*.

Neni 34
Korrigjimet

Korrigjimet në informacionin e përmendur në nenin 23 të këtij vendimi, duhet të identifikohen qartë.

Neni 35
Konfirmimi i marrjes së informacionit ndaj shteteve të tjera

Kur QNOD-ja merr informacion elektronik nga një shtet tjetër duhet të sigurojë që një mesazh marrjeje t'u dërgohet autoriteteve kompetente të atij shteti. Ky mesazh përfshin një konfirmim të marrjes.

Neni 36
Detyrimi për shkëmbimin e informacionit

Të dhënat e parashikuara në modelin *ad hoc* sipas nenit 33 të këtij vendimi, janë të detyrueshme në shkëmbimet e informacionit ndërmjet shteteve.

Neni 37
Periudha për të cilën raportohet

Të dhënat e përmendura në nenin 33 të këtij vendimi duhet të mbulojnë periudhën ndërmjet nisjes së fundit nga porti dhe përfundimit të zbarkimit. Të dhënat e udhëtimit të peshkimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit jepen kur kërkohen nga autoriteti kompetent.

Neni 38
Shkëmbimi i informacionit teknik

Autoritetet kompetente shqiptare shkëmbejnë me autoritetet e shteteve të tjera informacionin teknik të nevojshëm për të siguruar akses të ndërsjellë në librat elektronikë të anijeve të peshkimit.

Neni 39
Sigurimi dhe mbrojtja e të dhënave

Autoritetet kompetente sigurojnë:
a) që të dhënat e marra në përputhje me këtë vendim të ruhen në mënyrë të sigurt në bazat e të dhënave elektronike dhe garantojnë konfidencialitetin e tyre;
b) mbrojtjen e të dhënave nga fshirja aksidentale ose e paligjshme, humbja aksidentale, dëmtimi, përhapja ose konsultimi i paautorizuar.

V. DISPOZITA KALIMTARE

Neni 40
Koha e zbatimit

Detyrimi për raportimin elektronik të të dhënave për aktivitetin e peshkimit (zënie, zbarkim dhe transbordim) fillon nga data 1.7.2024.

Neni 41
Miratimi i modelit *ad hoc*

Modeli *ad hoc* i shkëmbimit të informacionit me shtetet e tjera do të miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për peshkimin, me instalimin e sistemit ERS në bordin e anijeve të peshkimit.

VI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 42
Shpenzimet

Shpenzimet e bëra për blerjen dhe instalimin në bordin e anijeve të peshkimit të pajisjeve ERS mbulohen nga buxheti i miratuar i ministrisë përgjegjëse për peshkimin.

Neni 43
Përjashtimi

Ky vendim nuk zbatohet për anijet të cilat përdoren vetëm për qëllime të akuakulturës.

Neni 44
Autoritetet zbatuese

Ngarkohen ministria përgjegjëse për peshkimin, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 631, datë 21.11.2022

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PËR FËMIJËT 6–15 VJEÇ

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3, të neneve 27 dhe 51, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët 6–15 vjeç, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.
3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror apo dhe/ose personave juridikë publikë/privatë, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe Inspektorati Përgjegjës për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

STANDARDET E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PËR FËMIJËT 6–15 VJEÇ

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

HYRJE

Shqipëria është në një proces të rëndësishëm reformash ambicioze në nivel kombëtar dhe vendor. Qeveria Shqiptare, mbështetur nga UNICEF, *Save the Children* dhe partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ka planifikuar dhe ndërmarrë reforma për mbrojtjen e fëmijëve, duke përmirësuar paralelisht sistemin kombëtar të shërbimeve sociale.

Reforma në sistemin e mbrojtjes dhe të kujdesit ndaj fëmijës synon të sigurojë një kalim gradual nga kujdesi alternativ rezidencial drejt shërbimeve të kujdesit me bazë komunitare për fëmijët dhe familjet e tyre. Qëllimi i reformës për kujdesin ndaj fëmijës është orientimi drejt shërbimeve shoqërore cilësore, që fokusohen fëmija/i rrituri/familja, sigurimi i mbështetjes me bazë komunitare, kurdo që është e mundur, dhe te minimizimi i ndërhyrjes në jetën e familjes, duke prodhuar impakt pozitiv dhe afatgjatë.

Procesi duhet të jetë i mirëplanifikuar dhe duhet të menaxhohet me kujdes në mënyrë që të shmanget mbivendosja e shërbimeve, të bazohet në praktikat dhe modelet ekzistuese, të minimizohen kostot e transformimit dhe të sigurohet përdorimi efikas i burimeve për edukimin, kujdesin shëndetësor dhe përkujdesjen për të mbështetur fëmijët dhe familjet e tyre në komunitet.

Zhvillimi dhe transformimi i shërbimeve shoqërore, veçanërisht në nivel komunitar, janë kritike për reformat në zhvillim dhe agjendat prioritare në vend, konkretisht deinstitucionalizimi dhe reforma e sistemit të kujdesit ndaj fëmijës, përgjigjja ndaj dhunës dhe përjashtimit social, të rinjtë dhe adoleshentët, si dhe iniciativat, në kuadër të zhvillimit të hershëm të fëmijëve.

VKM-ja nr. 106, datë 15.2.2017, "Për një ndryshim në VKM-në nr. 425, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore", të ndryshuar, në pikën 1 të vendimit parashikon ndryshimin e moshës së pranimit të fëmijëve në këto institucione, sipas tipologjive të caktuara të shërbimit, konkretisht: 0–5 vjeç; 6–15 vjeç dhe 16–18 vjeç, çka kërkon miratimin e standardeve specifike për këto grup-mosha.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të vlerësimeve të vazhdueshme për ofrimin e shërbimeve rezidenciale të përkujdesjes për fëmijët, mori nismën për rishikimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për fëmijët në institucionet rezidenciale.

PARIMET

Rishkrimi i standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët pa kujdes prindëror nga 6–15 vjeç, ka për qëllim të ofrojë një dimension të ri, në frymën e të gjitha ndryshimeve ligjore, në sistemin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë. Standardet plotësojnë detyrimet për zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015–2023 dhe ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

Ligji nr. 121/2016, "Për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë dhe ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", bazohen në parimet:

1. Universaliteti, fëmija është bartës i të drejtave që janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive;
2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën;
3. Drejtësia sociale;
4. Subsidiariteti;
5. Mbështetja shoqërore dhe ofrim i shërbimit të specializuar për çdo fëmijë;
6. Deinstitucionalizimi dhe decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijëve;
7. Partneriteti ndërmjet institucioneve dhe ndërhyrje ndërsektoriale;

8. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës, si dhe i të drejtave të njeriut;

9. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar;

10. Mosdiskriminimi dhe barazia;

11. Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale;

12. Garantimi i stabilitetit të vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimit të fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor e gjuhësor.

Gjatë hartimit të këtyre standardeve janë marrë në konsideratë të drejtat e sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa për të drejtat e Fëmijëve. Ligji nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" përkufizon shërbimet rezidenciale si shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në strehëzat rezidenciale, publike dhe jopublike

Standardet e reja të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët 6–15 vjeç, do të shërbejnë si një instrument bazë për sigurimin dhe matjen e cilësisë së shërbimeve në të gjitha institucionet publike dhe jopublike të ofrimit të këtyre shërbimeve dhe garantimin e ushtrimit të të drejtave të fëmijëve në bazë të ligjit nr. 18/2017, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë", në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", neni 56 (kreu IV) përcakton dhënien e masës emergjente të mbrojtjes për rastet e fëmijëve në rrezik të menjëhershëm dhe mbrojtjen e tij nëpërmjet vendosjes në një strehim të sigurt, siç mund të jetë (pika "c" e nenit 57) vendosja e fëmijës në një strehëz rezidenciale, kur nuk janë të mundura alternativat e tjera si familja biologjike apo kujdestare.

Në të gjitha rastet, kur strehimi rezidencial është zgjidhja e vetme, kërkohet që të sigurohet një nivel shërbimi, që siguron përkujdes cilësor të lartë, në përshtatje me mundësitë për ofrimin e shërbimeve shoqërore në Shqipëri, që të jetë i realizueshëm në një plan afatshkurtër apo afatmesëm nga të gjithë ofruesit e shërbimeve rezidenciale për fëmijët, që garanton bazat për zhvillim të mëtejshëm dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për fëmijët dhe që lejon një zhvillim të qëndrueshëm në një plan afatgjatë.

MODELI I PROPOZUAR: "SHTËPI-FAMILJE"

Koncepti bazë

Shtëpia-familje krijohet në ndërtesa normale banimi, duke iu referuar parametrave të banesave civile. Hapësirat janë të organizuara, si për zhvillimin e jetës së një familjeje të zakonshme, të ndara në zona dite (dhomë ndenjeje, kuzhinë) dhe zona nate, pa pengesa arkitektonike; numri i banjave është në përpjesëtim me kapacitetin mikpritës. Për shkak të karakteristikës së tipit familjar, nuk ka nevojë për një autorizim shëndetësor për kuzhinën, për hapësira apo shërbime që përdoren nga pjesëtarët e saj.

Në një shtëpi-familje jetojnë deri në 6 fëmijë të grup-moshës 6–15 vjeç dhe për ta kujdesen gra/nëna (përgjithësisht jo më shumë se katër) që u japin fëmijëve afeksionin, organizimin dhe funksionin e një familje. Në këto familje stimulohet jetesa si një familje e zakonshme, fëmijëve u nxitet krijimtaria dhe nisma, zhvillojnë aftësi specifike dhe fitojnë vlerësim për veten. Shtëpia-familje bëhet baza e tyre e sigurt, me vlerë terapeutike dhe rehabilituese. Ajo shëron dhe parandalon.

Veprimtaritë dhe cilësitë funksionale:

- stabilitet jetese të fëmijëve;
- organizim të jetës së përditshme në bazë të një modeli jete familjare, që respekton ritmet, aftësitë dhe potencialitetet e personave të mikpritur;
- përdorim sipas problematikave të fëmijëve të shërbimeve të pranishme në territor.

Nënat kujdesen për fëmijët jo vetëm për shkollimin, por edhe për ushqimin e tyre, edhe për veshjet, duke respektuar dëshirat dhe shijet individuale të fëmijëve, si në çdo familje të shëndetshme.

Nëpërmjet hartimit të standardeve, përfituesit, kategoria fëmijë 6–15 vjeç, do të plotësojnë më mirë nevojat e tyre, duke u rritur dhe edukuar në një mjedis familjar.

Sfida ka qenë që të krijohet një paketë standardesh për shërbimet rezidenciale për fëmijët 6–15 vjeç, me qëllim që fëmijët e rritur jashtë familjes të gjejnë një mjedis të sigurt, që u mundëson atyre rritjen dhe edukimin, si qytetarë të përgjegjshëm dhe plotësisht të

integruar në jetën e komunitetit, ose të mund të kthehen në familjet e tyre biologjike apo në familje që do të mundësojë rritjen e tyre.

Kujt i shërbejnë standardet?

Të gjithë aktorët, që nga përfituesit deri tek ofruesit e shërbimeve rezidenciale dhe bashkëpunëtorët e tyre janë të interesuar t'i përdorin standardet. Këto janë standarde minimale që synohet të zbatohen në të gjitha shërbimet rezidenciale për fëmijë 6–15 vjeç

- Fëmijët/familjet dëshirojnë të marrin një nivel të kënaqshëm shërbimesh. Prindërit dhe të afërmit e fëmijëve, që ndodhen në qendrat e shërbimeve rezidenciale dhe fëmijët e rritur kanë të drejtën të informohen mbi standardet, që të mund të kontribuojnë edhe ata në zbatimin e tyre.

- Ofruesit, ku përfshihen: institucionet publike, OJF-të, grupet e interesuara, ofruesit privatë dhe bashkëpunëtorët e tyre do t'i përdorin standardet si një udhërrëfyes në procesin e realizimit të shërbimeve rezidenciale.

- Organizatat që përfaqësojnë interesat e fëmijëve apo ato që merren me mbrojtjen e fëmijëve apo më gjerë me zhvillimin e të drejtave njerëzore.

- Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror me agjencitë e tij rajonale, Inspektorati për Shërbimet Shoqërore, autoritetet vendore, ku përfshihen këshillat e qarkut, bashkisë, do t'i përdorin standardet për licencimin, inspektimin dhe vlerësimin e shërbimeve shoqërore.

- Të gjitha autoritetet e tjera publike në nivel qendror, si: Ministria e Shëndetësisë, e Arsimit, e Pushtetit Vendor, e Drejtësisë etj.

Standardet, gjithashtu, mund të jenë të dobishme, për:

- Institucionet akademike dhe organizata të tjera të përfshira në veprimtari arsimore dhe/apo trajnuese për personelin që ushtron veprimtari në shërbimet shoqërore;

- Studiuesit që i drejtohen fushës shoqërore;

- Të tjerë si persona/biznese të interesuar apo edhe të angazhuar në fusha që ndërthuren me shërbimet shoqërore.

Çfarë fushash mbulojnë standardet?

Ky dokument përbëhet nga 12 standarde bazë. Krahas standardeve, jepen edhe kriteret e vlerësimit, treguesit e matjes së cilësisë së shërbimeve, udhëzues dhe rezultatet e pritura, si dhe anekset përkatëse, të cilat paraqesin format për secilin nga hapat e ndjekur për arritjen e qëllimeve të standardeve. Standardet janë hartuar, si: standarde të shërbimit bazë dhe standarde të detyrueshme për të gjithë personat që ofrojnë shërbime publike dhe jopublike. Standardet mbulojnë disa fusha, si:

1. Qëllimi i shërbimit dhe përshtatshmëria sipas qëllimit;
2. Plani i përkujdesjes;
3. Përgatitja për jetesë të pavarur;
4. Ushqyerja;
5. Paraqitja, veshja dhe nevojat materiale;
6. Shëndeti fizik, emocional, mendor dhe dentar;
7. Edukimi;
8. Argëtimi;
9. Ankimimi;
10. Mbrojtja nga abuzimi;
11. Mjedisi dhe akomodimi;
12. Stafi.

Standardet janë konceptuar si standarde të cilësisë, në kuptimin që ato do të përdoren si mjet për të arritur dhe njëkohësisht për të vlerësuar cilësinë e shërbimit që ofrohet për fëmijët 6–15 vjeç, që rriten në institucionet rezidenciale, jashtë familjeve të tyre biologjike. Ato janë ndërtuar në 4 seksione. Së pari, përcaktimi i standardit që do të arrihet. Ky pasohet nga një përcaktim i rezultatit që arrihet te fëmijët nga zbatimi i standardit përkatës. Së treti, kriteret për vlerësimin e tij dhe së fundi treguesit për matjen e cilësisë së zbatimit të standardit që vlerësojnë nëse standardet janë arritur. Këta tregues do të shërbejnë edhe si bazë për inspektimin e shërbimeve rezidenciale për fëmijët. Në këtë mënyrë, të gjithë pjesëmarrësit në sistemin e shërbimeve rezidenciale për fëmijët dinë se ku duan të arrijnë me këtë lloj shërbimi dhe se si të marrin arritjet e tyre.

STANDARDI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILËSISË
I. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6 – 16 15 vjeç zotëron dokumentin ku përshkruan misionin, qëllimin, objektivat, si dhe modelin e shërbimit që ofrohet.	Fëmijët kanë njohuri për llojin e shërbimit që ofrohet, si dhe metodologjinë e përdorur për përkujdesjen ndaj tyre. Një deklaratë e qartë se si ofrohet shërbimi është e disponueshme për fëmijët, prindërit dhe të interesuarit e tjerë.	1. Një përkufizim i qartë i misionit dhe i qëllimit të shtëpisë, ku parashtrohen shërbimet që ajo ofron, është lehtësisht i dukshëm për të gjithë përdoruesit e kësaj shtëpie. Ky përkufizim shkruhet në Deklaratën e Qëllimit. Format e shprehjes dhe prezantimi janë të qarta në vende të dukshme, në formën edhe të fletëpalosjeve, posterave, faqeve në internet etj.	1.1 Ekziston një dokument zyrtar lidhur me Deklaratën e Qëllimit.
			1.2 Personeli mund të demonstrojë që e kupton dhe e zbaton politikën përkatëse të përshkruar në deklaratën e qëllimit. Në deklaratën e qëllimit të përfshihen edhe mendime apo sugjerime nga vetë fëmijët.
	Qendrat me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ofron një paketë shërbimesh, në përputhje me nevojat e fëmijëve në bashkëpunim edhe me ofruesit alternativë të shërbimeve, për të mundësuar kujdes dhe mirëqenie për çdo fëmijë në interesin e tij më të lartë.	2. Prindërit, fëmijët, përdoruesit e shërbimeve kanë akses te deklarata e qëllimit, misioni dhe manuali.	2.1 Kopje të deklaratës së qëllimit janë të dukshme në të gjithë shtëpinë familje, janë të disponueshme për përdoruesit, si dhe në forma lehtësisht të kuptueshme edhe nga fëmijët.
		3. Personeli ofron informacion lidhur me funksionimin e shtëpisë ose të shërbimit që do t'u ofrohet fëmijëve, cilat janë shërbimet minimale, shtesë apo të specializuara që ofrohen në shtëpi apo mundësohen prej saj. Personeli dhe fëmijët angazhohen në mirëmbajtjen e mjediseve personale dhe të përbashkëta, respektimi i orareve të hyrjeve dhe të daljeve, të drejtave dhe detyrimeve.	3.1 Fëmijët, prindërit ose të afërmit konfirmojnë se kanë marrë informacion nga stafi mbi deklaratën e qëllimit dhe e kuptojnë atë, pasi ajo është diskutuar me ta. Përfituesit kanë një kopje të deklaratës së qëllimit. Konfirmimi duhet të jetë i dokumentuar.
			3.2 Rregullore e brendshme ku përcaktohen qartë dhe hapur rregullat e jetesës në shtëpi për fëmijët dhe personelin..
		4. Deklarata e qëllimit rishikohet, përmirësohet në mënyrë periodike dhe pas kësaj vijojnë modifikimet përkatëse në dokumentet dhe praktikat e tjera.	4.1 Dokumentet dhe aktet zyrtare tregojnë që deklarata e qëllimit është diskutuar dhe rishikuar rregullisht.
II. Plani i përkujdesjes për fëmijë paraqet në mënyrë të qartë nevojat e vlerësuara të fëmijëve, objektivat dhe aktivitetet e përkujdesjes, krijimin e mundësive për të plotësuar këto nevoja nga personeli i shtëpisë-familje dhe mënyrën se si do të vlerësohet efektiviteti i përkujdesjes për çdo element (komponent) të planit.	Për çdo fëmijë ka një plan individual. Nevojat e fëmijëve vlerësohen dhe plotësohen në mënyrë efektive dhe të plotë. Planet me shkrim paraqesin mënyrat, afatet se si do të plotësohen nevojat dhe si e kur do të zbatohen këto plane. Ato paraqesin edhe progresin e arritur në zbatimin e planit.	1. Ekipi me specialistë është përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të nevojave të fëmijëve, për secilin nga komponentët e shërbimit: shëndeti, arsimi, akomodimi afatgjatë, marrëdhëniet familjare, aktivitetet sociale. 2. Në rastet kur fëmijët kanë nevoja komplekse për trajtim në grupet multidisiplinare përfshihen edhe specialistë jashtë qendrës për të ndihmuar si në vlerësim ashtu edhe në planin e ndërhyrjes dhe trajtimit të tij.	1.1. Është ngritur një ekip multidisiplinar, që njeh përgjegjësitë e tij lidhur me vlerësimin dhe planifikimin në fushën e përkujdesjes. Çdo pjesëtar i ekipit ka të qartë detyrën e tij dhe ka përgatitur e përditësuar rubrikën që ka nën përgjegjësi. 1.2 Ekipi multidisiplinar ngrihet në fillim viti nga drejtuesi me specialistët e fushës: punonjës social/psikolog/mjek edukator/kujdestar apo specialistë të tjerë përfshirë edhe PMF-në, sipas rastit.
		2. Ekipi ka kryer ose po kryen një vlerësim të nevojave për çdo fëmijë.	2.1 Për çdo fëmijë ka një dosje personale që përmban vlerësimin e kryer mbi nevojat e fëmijëve të dokumentuar.
		3. Është hartuar dhe po zbatohet një plan përkujdesjeje për çdo fëmijë ku synohet pjesëmarrja/përfshirja aktive e fëmijëve në hartimin dhe zbatimin e planit.	3.1 Është i disponueshëm për fëmijët, si vlerësimi, ashtu edhe plani lidhur me përkujdesjen. Në dosjen personale ka shënime mbi progresin e shënuar për zbatimin e planit. Plani është nënshkruar edhe nga përfituesi.
		4. Fëmijët janë pjesë e procesit të vlerësimit dhe planifikimit të përkujdesjes.	4.1 Ka dëshmi, (dok.) që vlerësimi i nevojave dhe plani janë diskutuar me fëmijët, prindërit/të afërmit e tyre, personin përgjegjës për fëmijët dhe që janë kuptuar prej tyre..

		5. Plani i përkujdesjes përfshin objektiva të qartë, mjetet për arritjen e objektivave, kontrollet periodike mbi progresin e bërë.	5.1 Janë përcaktuar objektiva të qartë për veprime dhe personi përgjegjës për realizimin e tyre, mjetet për arritjen e objektivave dhe sa do të përfshihet vetë fëmija.
		6. Është caktuar një person përgjegjës për zbatimin e planit dhe raportimin e progresit për çdo fëmijë.	6.1 Për çdo fëmijë ka një edukator/kujdestar, që kujdeset në bashkëpunim me fëmijët për zbatimin e planit. 6.2 Kujdestari/edukatorët në shtëpi-familje punojnë me fëmijët për të nxitur modelin e duhur të jetës dhe i drejtojnë ata në rrugën e duhur për të arritur besimin, zhvillimin e aftësive të jetës së përditshme dhe përmirësimin e aftësive dhe vlerave të tyre individuale.
		7. Për çdo fëmijë në këtë dosje përfshihet: i. dokumentacioni i duhur në përputhje me legjislacionin për pranimin e tij në shtëpi-familje; ii. historinë e tij personale; iii. vlerësimi i nevojave specifike të çdo fëmije, në lidhje me zhvillimin e tij psikosocial. Çdo fëmijë ka të drejtën të njihet me përmbajtjen e dosjes personale në çdo moment.	7.1 Personi përgjegjës për fëmijën mund të flasë me kompetencë për të, si edhe të dëshmojë për situatën e tij dhe të familjes së tij. Vlerësimi i nevojave të fëmijës dhe të familjes së tyre bëhet me qëllim që të përcaktohet ndihma e duhur dhe shërbimi që i plotëson më mirë këto nevoja.
		8. Ekziston bashkëpunim me shërbimet e tjera (publike, private, OJF-të) për të siguruar që nevojat e identifikuara të fëmijëve të plotësohen, si edhe të ofrohet një mbështetje shtesë për fëmijët.	8.1 Ka dokumente që dëshmojnë se gjatë hartimit të planeve të përkujdesjes apo të rishikimit të tyre janë kërkuar informacione nga organizatat e tjera (shkollat, institucionet shëndetësore, OJF-të e tjera).
III. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç harton një plan përgatitor për fëmijët që largohen nga përkujdesja në institucion dhe lëvizin (transferohen) në forma të tjera të përkujdesjes (integrim në familjen biologjike, birësim, kujdestari).	Fëmijët mbështeten dhe përgatiten për t'u larguar nga qendra shtëpi-familje 6–15 vjeç drejt një jete në familjet e tyre, qoftë biologjike, birësuese, apo kujdestare.	1. Një ekip është përgjegjës për hartimin e planit përgatitor për largimin nga përkujdesja.	1.1 Ekipi është ngritur dhe funksionon. Duke filluar nga mosha, 16 vjeç (ose me parë (nëse fëmija largohet me shpejt nga institucioni) bëhen diskutime me fëmijët lidhur me të ardhmen e tyre, kur do të largohen nga shtëpia. Shqyrtohen me fëmijët mundësitë realiste që kanë të bëjnë me këtë të ardhme (edukimi, formimi profesional etj.).
			1.2 Me fëmijët bëhen diskutime lidhur me të ardhmen e tyre, kur do të largohen nga qendra rezidenciale me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç. Shqyrtohen me to opsionet realiste, që kanë të bëjnë me këtë të ardhme (edukimi, formimi profesional etj.).
			1.3 Për çdo fëmijë ka një plan për largimin nga Qendra shtëpi-familje 6–16 vjeç, drejt jetesës në familje. Puna për planin e largimit të fëmijëve duhet të fillojë një vit përpara.
		2. Personeli, fëmijët, prindërit dhe/ose të afërmit apo të interesuar të tjerë për fëmijën, punojnë së bashku për përgatitjen e një programi individual për të, sipas moshës, nevojave dhe mënyrës së re të jetesës së tij në të ardhmen. Në planin e largimit, rikthimit në familje përfshihet edhe vlerësimi i PMF-së (punonjësi për mbrojtjen e fëmijës) në bashkinë, aty ku fëmija ka familjen e vet.	2.1 Në dosjen e fëmijës ka dëshmi lidhur me diskutimet që janë bërë rreth rrezikut që ekziston për shfrytëzimin e tyre, shëndetin seksual, përdorimin e drogës, alkoolit etj.
			2.2 Fëmijët konfirmojnë që ka pasur diskutime të tilla me ta. Plani i largimit bëhet me përfshirjen e fëmijës, prindërve apo kujdestarit të tij.
			2.3 Në bashkëpunim me punonjësin përgjegjës, organizohen aktivitete dhe diskutime tematike që fëmijët të fitojnë aftësi në menaxhimin e jetës së tyre duke përfshirë vetëvlerësimin, aftësimin për pastërtinë, higjienën, rregullin dhe proceset edukuese.

IV. Fëmijëve u sigurohen dhe ofrohen ushqime dhe lëngje të shëndetshme, të sigurta, të shumëllojshme e në sasi të mjaftueshme, sipas normave ushqimore të miratuara për grup-moshën, si dhe që plotësojnë dëshirat e tyre.	Fëmijët marrin ushqime me vlera ushqyese që plotësojnë nevojat e tyre në përputhje me grup-moshën. Fëmijëve me nevoja të veçanta ushqimore u sigurohet ushqim i përshtatshëm. Sipas formave të zgjedhjes së shërbimit në IPSH mund të përdoret edhe shërbimi *catering* për vaktet të ndryshme.	1. Fëmijët marrin një dietë të shëndetshme, ushqyese dhe të ekuilibruar sipas nevojave të tyre të rritjes dhe zhvillimit dhe nevojave kulturore, fetare.	1.1 Ekziston një menu javore që u përshtatet moshave të fëmijëve, nevojave të tyre për lëndë ushqyese dhe kalori. 1.2 Menuja hartohet nga një komision i përbërë nga mjeku, kuzhinieri, financier dhe fëmijët, si dhe u bëhet e ditur personave të tjerë të interesuar për fëmijët.
			1.2 Nga diskutimet me grupe të fëmijëve më të rritur konfirmohet se fëmijët janë përfshirë në hartimin e menysë dhe kanë shprehur mendimin e tyre në zgjedhje.
			1.3 Regjistrat ku janë shënuar porositë konfirmojnë se janë blerë rregullisht ushqime, fruta dhe perime të freskëta. Janë të disponueshme fruta dhe perime dhe ushqime të ndryshme të freskëta në ambientet e shtëpisë-familje. - Në përcaktimin e zgjedhjes së ushqimeve me procedurat të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi, merret paraprakisht mendimi dhe zgjedhja e fëmijëve. Ka dokumente, që verifikojnë dëshirat dhe zgjedhjet e fëmijëve, të marra parasysh në planifikim.
			1.4 Janë plotësuar kushtet lidhur me shëndetin, higjienën, përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimeve. Kampioni ushqimor ruhet 24 orë në kushtet e duhura.
			1.5 Ka evidenca që tregojnë se në raste të veçanta, siç janë ditëlindjet e fëmijëve përgatitet diçka e veçantë.
		2. Me mbështetjen e personelit, fëmijët kanë të drejtë për të përgatitur ushqime dhe lëngje për veten e tyre.	2.1 Sipas dëshirës fëmijë përgatisin vetë ushqimin e tyre në fundjavë, si edhe vaktet e mëngjesit, darkës ose zemrës.
		3. Ambienti i e ngrënies dhe mobiliet u përshtaten numrit, nevojave dhe moshës së fëmijëve. - Magazina apo ambienti i ushqimeve është i ndarë nga detergjente apo solucioneve të tjera.	3.1 Në ambientin e kuzhinës në çdo shtëpi-familje (kuzhinë), fëmijët e përdorin si një vend ku bëjnë ushqimin e shpejtvetë, çaj, ëmbëlsira etj. dhe gatuajnë me ndihmën e stafit.
		4. Vaktet shërbehen në orare të rregullta, kështu që fëmijët e dinë kohën e ngrënies. Sipas nevojave fëmijët mund të përdorin në çdo kohë ushqimin, frutat apo lëngjet që pëlqejnë.	4.1 Bisedat me fëmijë konfirmojnë njohjen e të drejtave të tyre në këndvështrimin e ushqyerjes.
V. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç plotëson nevojat për veshje dhe gjëra personale të domosdoshme të fëmijëve.	Fëmijët vishen në mënyrë të rregullt. Ata zgjedhin vetë veshjet dhe gjërat e domosdoshme personale që plotësojnë nevojat e tyre.	1. Fëmijët janë në gjendje të zgjedhin kur bëhet fjalë për pamjen e tyre të jashtme (rrobat, prerja e flokëve) dhe gjërat e tyre personale, duke i blerë ato me mbështetjen e stafit.	1.1 Ka evidencë që tregon se fëmijët janë të përfshirë në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me paraqitjen e tyre të jashtme.
			1.2 Fëmijët nuk veshin rroba të përdorura të njëri- tjetrit.
		2. Fëmijët duhet të jenë në gjendje apo të kenë orendi të përshtatshme, për të ruajtur gjërat e tyre personale. Dollap, komodinë raft për mbajtje të gjërave personale. Secili fëmijë ka në dollapin e vet pajisjeve hotelerike (çarçafë, jastëk, batanije, jorganë etj.) dhe përdor ato sa herë është e nevojshme.	2.1 Të kenë hapësira në dhomat e tyre të gjumit për të mbajtur rrobat.
			2.2 Nuk ka rroba për përdorim të përbashkët.
			2.3 Secili nga fëmijë ka një vend personal për të mbajtur rrobat, si edhe sende të tjera personale.
		3. Fëmijët duhet të inkurajohen dhe të ndihmohen, nëse është e nevojshme, për të administruar	3.1 Dokumentacioni i regjistruar (listëpagesa) dëshmon se fëmijët kanë përfituar pagesën mujore, në masën e

		gjendjen e tyre financiare (paratë e tyre).	përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.
		4. Stafi këshillon fëmijët lidhur me përdorimin e tualetit, higjienën personale, si dhe përdorimin e prodhimeve kozmetike. 5. Sipas nevojave për çdo fëmijë sigurohen mjetet dhe detergjentet e higjienës personale. Ka evidenca të shkruara për marrjen e tyre në përdorim nga fëmijët.	4.1 Ditarët ditorë që përdorin këto shtëpi ose dosjet personale për secilin fëmijë dëshmojnë se janë bërë diskutime me fëmijët mbi këto tema.
VI. Shërbimet mjekësore, dentare dhe shërbime të tjera ofrohen sipas nevojave fizike, emocionale dhe shëndetësore të fëmijëve. Këto nevoja identifikohen dhe merren masat e duhura për t'i plotësuar ato. Fëmijët udhëzohen mbi çështjet që kanë të bëjnë me përkujdesjen personale dhe u ofrohet këshillim mbi çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin.	Fëmijët jetojnë në një mjedis të shëndetshëm. Nevojat e tyre shëndetësore janë identifikuar dhe ofrohen shërbime për t'i plotësuar ato. Te fëmijët nxiten mënyra të shëndetshme jetese.	1. Çdo fëmijë i nënshtrohet vlerësimit mjekësor, sipas nevojave të tij shëndetësore. - Sipas rrethanave të referimit në kushte emergjence, fëmijët i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimit mjekësor për vlerësimin e shëndetit të tyre. - Sipas protokollit shëndetësor në rastet e fëmijëve me problem të shëndetit merren masa për trajtimin e tij në ambient të ndarë për mos mbartur risk për fëmijët e tjerë.	1.1 Të dhëna të regjistruara në këto shtëpi, dëshmojnë se çdo fëmijë i është nënshtruar vlerësimit të parë mjekësor, vaksinat (kontrolleve mjekësore, të syve dhe të gojës) dhe këto kontrolle janë kryer në mënyrë periodike.
		2. Personeli nxit dhe inkurajon mirërritjen, ushqyerjen dhe një mënyrë jetese të shëndetshme (ushqime të shëndetshme, dietë e balancuar, ndërgjegjësim për rreziqet e kequshqyerjes).	2.1 Personeli ofron një shembull të mirë për jetesë të shëndetshme dhe ka zhvilluar seanca diskutimi me fëmijët, për njohjen e rreziqeve, që vijnë nga përdorimi i duhanit dhe i alkoolit dhe substancave narkotike, si dhe ndalimin e përdorimit të tyre në ambientet e institucionit.
		3. Çdo fëmijë, në përshtatje me moshën, ka kartelë shëndetësore të kujdesit për mirërritje dhe zhvillim, që njihet dhe zbatohet nga stafi i shtëpisë, ku përfshihen: i. historia personale e fëmijëve (lindja, shëndeti, familja e tij etj.); ii. historia dhe ecuria e sëmundjeve dhe e problemeve të kaluara; iii. historia e sëmundjes aktuale; iv. ndërhyrje dhe trajtime të veçanta mjekësore; v. alergji dhe reaksion ndaj ilaçeve; vi. shëndeti i gojës; vii. përfshirja e prindërve/të afërmve të fëmijëve në çështje që kanë të bëjnë me shëndetin.	3.1 Kartelat shëndetësore menaxhohen nga mjeku/infermieri, dhe përmbajnë të gjitha vizitat, kontrollet peroidike të fëmijës. Në rastet e fëmijëve me nevoja të veçanta, ndiqen nga specialisti përkatës dhe ka të njëjta të drejta si gjithë fëmijët e tjerë.
			3.2 Në kartelat që disponon qendra, ka dokumentacion, receta, rekomandime lidhur me marrëdhëniet midis shtëpisë në fjalë dhe profesionistëve të fushës së shëndetit, spitaleve etj., për kurimin e fëmijëve.
		4. Çdo fëmijë i nënshtrohet një kontrolli dentar dhe të përgjithshëm çdo 6 muaj.	4.1 Të dhënat e regjistruara individuale dëshmojnë se fëmijës i është siguruar mjekim për sëmundje të ndryshme kronike (p.sh. diabeti, epilepsia etj.), mjekimi i duhur dhe janë marrë parasysh rekomandimet nën mbikëqyrjen e mjekut. - Në shtëpi-familje ka një kuti emergjence me medikamentet dhe pajisjet e duhur.
VII. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ndjek një politikë edukimi që synon të nxisë dhe mbështesë edukimin dhe arsimimin e fëmijëve.	Edukimi i fëmijëve nxitet në mënyrë aktive, duke u konsideruar një proces i rëndësishëm për përgatitjen e fëmijëve për jetesë të pavarur.	1. Personi përgjegjës për fëmijën e mbështet atë gjatë gjithë periudhës së edukimit të tij shkollor.	1.1 Punonjësi përgjegjës edukatori bashkërisht me fëmijën përcaktojnë programin e vijueshmërisë në procesin mësimor, p.sh. ai realizon takime me mësuesit në shkollë dhe mbështet atë gjatë gjithë kohës.
		2. Çdo i ri ka një plan edukimi që përfshin: - objektivat; - raportet e rregullta të progresit. - për fëmijët të cilët kanë problematika të veçanta me ecurinë	2.1 Progresi i fëmijëve në aspektin edukativ është pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit dhe përmirësimit periodik të planit të përkujdesjes (shihni standardin 2). Progresi i fëmijë është i matshëm dhe i verifikueshëm nëpërmjet dokumenteve që

		në shkollë, edukatori duhet të hartojë një plan individual, ku të jenë të përcaktuara të gjithë hapat që duhet të ndjekë fëmija. Në këto plane të pasqyrohen rezultatet e vlerësimit dhe të punës direkt për progresin e fëmijës.	disponon edukatori.
			2.2 Dosjet sipas rasteve individuale, si dhe intervistat me fëmijën tregojnë për diskutimet që janë zhvilluar me fëmijën lidhur me ecurinë e tij/të saj shkollore.
		3. Ka mjedise studimi ku fëmijët mund të mësojnë dhe të përgatisin detyrat e tyre të shtëpisë mjedise të cilat të jenë të përshtatura me mjete didaktike dhe lojëra të ndryshme që zhvillojnë zhvillimin intelektual të tyre.	3.1 Qendra disponon bibliotekë me libra dhe revista, sipas moshës së fëmijëve.
		4. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ofron në mënyrë të rregullt materiale shkollore për fëmijë. Personeli i ndihmon fëmijët gjatë përgatitjes së tyre.	4.1 Ka evidencë për ekzistencën e një buxheti të akorduar veçanërisht për këtë gjë.
VIII. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6-15 vjeç organizon dhe planifikon që çdo fëmijë të marrë pjesë në një sërë aktivitetesh të përshtatshme për të kaluar kohën e lirë, si dhe që të zhvillojnë nevojat fizike, emocionale e sociale të tyre. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç planifikon dhe siguron burime financiare për të mbështetur aktivitetet e kohës së lirë dhe mjediset e nevojshme për t'i realizuar ato.	Fëmijët janë në gjendje të ndjekin interesat e tyre të veçantë, të ndërtojnë marrëdhënie pozitive, të zhvillojnë vetëbesimin në aftësitë e tyre. Personeli mbështet dhe inkurajon fëmijët për t'u përfshirë në aktivitete në kohën e lirë.	1. Ekziston një program i strukturuar i aktiviteteve të kohës së lirë, i disponueshëm edhe për fëmijët. Fëmijët duhet të përfshihen në jetën kulturore dhe artistike, sociale edhe jashtë institucionit.	1.1 Janë të planifikuara dhe të dokumentuara programe për kalimin e kohës së lirë, të cilat përfshihen në informacionin që u jepet fëmijëve, prindërve/të afërmve. Qendra disponon ambiente të përshtatura për kohën e lirë të fëmijëve, si brenda, ashtu dhe jashtë saj.
		2. Disa nga veprimtaritë e kohës së lirë janë të planifikuara sipas moshës, kulturës, fesë dhe nevojave të veçanta të fëmijëve.	2.1 Diskutimet me grupin e fëmijëve (qoftë në grup apo individualisht) tregojnë nëse fëmijëve u është krijuar mundësia për t'u marrë me aktivitetet për të cilat ato kanë vetë interes apo aktivitete të përshtatshme për nevojat e tyre.
		3. Fëmijët janë aktivë në organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve.	3.1 Ka të dhëna të dokumentuara për takime që tregojnë se janë zhvilluar diskutime me fëmijët lidhur me aktivitetet e tyre të kohës së lirë. Dokumentimi tregon se fëmijët janë përfshirë në organizimin e këtyre aktiviteteve.
		4. Drejtuesi i shtëpisë siguron burimet financiare, njerëzore dhe mjediset e duhura për të mbështetur aktivitete të kohës së lirë.	4.1 Pajisjet, mjetet dhe mjediset për realizimin e aktiviteteve sigurohen nga personeli dhe drejtuesi i shtëpisë.
		5. Fëmijët inkurajohen për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie korrekte me fëmijët e moshës së tyre në komunitet.	5.1 Në programin e kohës së lirë duhet të përfshihen në aktivitete që organizohen në komunitet, për të nxitur marrëdhëniet sociale.
IX. Fëmijët kanë të drejtën për t'u ankuar nëse nuk janë të kënaqur me ndonjë aspekt të jetesës në shtëpinë-familje. Çdo ankesë trajtohet në mënyrë serioze, pa vonesë dhe i jepet një përgjigje e plotë brenda një maksimumi prej 10 ditësh. Fëmijët apo ankuesi, mbahen në dijeni për progresin lidhur me trajtimin e saj.	Çdo ankesë trajtohet në mënyrë serioze dhe pa vonesë. Ankimuesi informohet lidhur me progresin e çështjes.	1. Ka procedurë ankimimi, që bën të mundur bërjen e ankesave, e cila është shprehur qartë dhe e afishuar. Shqyrtimi i ankesës bëhet me përfshirjen e fëmijës.	1.1 Në shtëpi gjenden fletushka të thjeshta dhe të kuptueshme për fëmijët, ose mënyra të tjera të informacionit, që promovojnë procedurat e ankimimit dhe afatet kohore. Ka një kuti ankimimi në vend të dukshëm për fëmijët.
			1.2 Procedura përcakton pjesëtarët e grupit që shqyrton të gjitha ankesat, si edhe ka kompetencën për të filluar të gjitha veprimet e përshtatshme. Pjesë e grupit që shqyrton ankesat është edhe një përfaqësues

			nga fëmijët, i cili zëvendësohet me rotacion, p.sh. një herë në tre muaj.
		1. Në qendër ka një kuti ankesash e cila përdoret dhe hapet sipas procedurave të hartuara. 2. Fëmijëve, prindërve, të afërmve të tyre, dhe stafit iu ofrohet një informacion lidhur me mënyrën se si bëhet ankesa. Ndërkohë ata duhet të kenë të drejtën ta përdorin këtë, pa u diskriminuar. Mënyra e ankimimit verbal, me shkrim, e drejtpërdrejtë me stafin apo e shprehur në kutinë e ankesave përcaktohet në procedurat e ankimimit, të cilat gjenden të shkruara në qendër dhe njihen nga fëmijët.	2.1 Kopje të fletushkës lidhur me ankimimin janë përfshirë në informacionin që u ofrohet fëmijëve/prindërve përpara pranimit në institucion.
			2.2 Fëmijët dhe stafi kanë njohuri mbi procedurën e ankimimit.
			2.3 I gjithë stafi ka dijeni të plotë dhe është i trajnuar lidhur me përdorimin e procedurave të ankimimit.
			2.4 Ka të dhëna të regjistruara që tregojnë për ankesat që janë bërë, mënyrën e zgjidhjes, si edhe afatet për trajtimin e tyre.
		3. Ankesat zgjidhen brenda periudhës së përcaktuar.	3.1 Ka të dhëna të regjistruara që tregojnë për afatet e trajtimin e tyre.
			3.2 Në shtëpi organizohen takime me fëmijë për diskutime me fokus procedurën e ankimimit. Këto takime dokumentohen. 3. Dokumente të regjistruara, drejtuar personit që bën ankimimin për ta vënë në dijeni për rezultatet e arritura nga ky proces.
X. Ka procedura që nxisin sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve dhe që sigurojnë mbrojtjen e tyre nga abuzimet. Procedurat njihen dhe kuptohen nga i gjithë personeli (përfshirë personelin e ri, të vjetër, vullnetar si edhe personelin e përkohshëm)	Mirëqenia e fëmijëve nxitet dhe ata mbrohen nga abuzimet.	1. Personeli që punon me fëmijët ka dëshmi penaliteti të pastër.	1.1 Kontrollet lidhur me dëshmitë e penalitetit janë të paraqitura në dosjet individuale të personelit.
		2. Përkufizim i qartë i termit "abuzim" dhe "dhunë" kuptohet nga personeli dhe fëmijët. - Fëmijëve u ofrohet gjithë informacioni i nevojshëm, për t'u njohur me politikat e mbrojtjes ndaj dhunës apo ndaj abuzimit.	2.1 Informacioni i ofruar fëmijëve dhe personelit gjatë emërimit të tij, përfshin përkufizime të qarta lidhur me atë se çfarë do të thotë në këtë kontekst fjala "abuzim" dhe "dhunë".
		3. Ka procedura lidhur me raportimin e rasteve të "abuzimit". Po ashtu përgatitet një plan veprimesh që duhet të ndërmerren në rast abuzimesh.	3.1 Trajnimi për stafin përfshin diskutime lidhur me situatat abuzive dhe mënyrën se si janë trajtuar ato. Ka edhe udhëzues të disponueshëm për stafin.
			3.2 Ekziston një plan i qartë për veprimet që duhet të ndërmerren në raste abuzimi dhe dhune.
			3.3 Ka të dhëna të qarta e të regjistruara mbi incidentet e abuzimit, si edhe mënyrën se si janë zgjidhur këto raste.
		4. Hartohet dhe zbatohet një program terapie për të trajtuar traumat që ka përjetuar fëmija që është përfshirë në abuzim. Ky program duhet të përfshijë udhëzime për personelin, personin përgjegjës për fëmijët, si dhe personin abuzues apo dhunues.	4.1 Në rastet e një abuzimi të mundshëm, të dhënat e regjistruara tregojnë se këto janë trajtuar në mënyrën e duhur nga personeli dhe se (kur është e nevojshme me ndihmën e një specialisti) është ofruar terapia e përshtatshme për fëmijët.
			4.2 Është caktuar një person për të vizituar fëmijët në mënyrë periodike dhe për të marrë pjesë në rishikimin e trajtimit të tij/saj.

		5. Njihet dhe zbatohen Kodi i Sjelljes dhe procedura e mbrojtjes së fëmijëve.	5.1 Ka dokumente që Kodi i Sjelljes dhe procedurat e mbrojtjes së fëmijëve njihen nga personeli dhe fëmijët.
XI. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç siguron mjedis fizik të përshtatshëm, mikpritës, si një shtëpi-familje 6–15 vjeç dhe të një cilësie të mirë për fëmijët, personelin, prindërit apo personat e tjerë të interesuar, në përputhje me qëllimin dhe funksionin e saj. Qendra shtëpi-familje 6–15 vjeç mbahet në rregull dhe e pastër.	Fëmijët jetojnë në një shtëpi me hapësira të nevojshme, të mobiluara dhe mirëmbajtur, sipas nevojave të fëmijëve. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ofron lehtësira, për përdorimin e mjediseve të saj dhe u mundëson fëmijëve të mbajnë kontakte me familjet e tyre.	1. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç zbukurohet dhe mobilohet për të krijuar një mjedis të këndshëm, shtëpi-familje për grup-moshën 6–15 vjeç të përshtatshëm për numrin, gjininë dhe moshën e fëmijëve që strehohen atje.	1.1 Tregohet kujdes që fëmijët të jetojnë në mjedise të pastra, të lyera këndshëm dhe në njësi të vogla tip shtëpi- familje.
		2. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ku jetojnë fëmijët është një vend i sigurt.	2.1 Në shtëpi gjendet kutia e ndihmës së shpejtë, si dhe mjetet e nevojshme për fikjen e zjarrit, dalje emergjence, numra të afishuar, se kë duhet të njoftojnë në situata emergjencash shëndetësore, sigurie, rënie zjarri etj.
		3. Organizohen mbledhje javore me fëmijë ose nga vetë fëmijët për të diskutuar rreth funksionimit të tyre, problematikave që ata kanë në bashkëjetesë, çfarë duhet të ndryshojnë, përmirësojnë.	3.1 Mbledhjet dokumentohen dhe vërejtjet apo sugjerimet vlerësohen nga stafi.
		4. Në dhomë fëmijët kanë një shtrat dhe pajisje shtrati të përshtatshme, vend për të ndenjur (për t'u ulur), perde apo mbulesa të tjera, ndriçim të mjaftueshëm për të lexuar, tapet dhe mbulesa të tjera të përshtatshme dyshemeje, si edhe ngrohje. Fëmijët kanë dollapë për vendosjen e rrobave, që mund të mbyllet apo ndryshe vend të sigurt të depozitimit të gjërave të tyre personale.	4.1 Fëmijët gjenden në dhoma me jo më shumë se 4 fëmijë, dhe gëzojnë intimitet (jetë private) brenda dhomave të tyre të gjumit.
			4.2 Fëmijët kanë krevat, çarçafë e mbulesa të përshtatshme. Këto të fundit janë të pastra dhe lahen rregullisht.
			4.3 Ka një dollap që mbyllet me kyç ose e thënë ndryshe një vend i sigurt depozitimi për sendet personale.
		5. Në ndarjen e fëmijëve në dhomat e gjumit merret parasysh garantimi i sigurisë dhe i shmangies së mundësisë për sjellje abuzive.	5.1 Fëmijët janë nëpër dhoma me fëmijë të së njëjtës moshë dhe gjini.
		6. Fëmijë janë të aftë dhe inkurajohen të personalizojnë dhomat e tyre të gjumit.	6.1 Hapësira e tyre personale zbukurohet sipas dëshirës së fëmijëve, me një pikturë të veçantë të marrë nga librat, fotografitë etj.
		7. Ekziston një dallim midis hapësirës private dhe të përgjithshme të banimit në shtëpinë në fjalë.	7.1 Ka ndarje ndërmjet hapësirave që përdoren si dhoma gjumi, kuzhinës, dhomës së ngrënies, dhomës së studimit, lavanterisë, dhomës ku fëmijët qëndrojnë dhe kalojnë kohë së bashku, banjave etj.
		8. Ka dhoma ku fëmijët mund të takohen privatisht me familjarë, si edhe hapësira për aktivitete private, për të luajtur, për të pushuar, të cilat nuk prekin aktivitetet e tjera të tyre. Çdo vizitor duhet të nënshkruajë paraprakisht deklaratën e vizitorit, në lidhje me politikat e mbrojtjes së fëmijëve.	8.1 Nga diskutimi me fëmijët rezulton se ata janë në gjendje të takohen privatisht me vizitorët dhe punonjës të tjerë që kanë interes të takohen me to.
XII. Ekziston një dokument i cili përcakton strukturën, numrin, procesin e përzgjedhjes dhe të rekrutimit të punonjësve. Nëpërmjet programeve të trajnimit zhvillohen kompetencat e përgjithshme të personelit, si	Ekziston një procedurë e rregullt dhe e përcaktuar nga ligji për përzgjedhjen e stafit në përputhje me shërbimin që ofron qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç dhe nevojat e fëmijëve. Sigurohet që fëmijët përfitojnë	1. Dokumente të regjistruara ku paraqiten struktura e stafit dhe numri i tij, procesi i përzgjedhjes dhe rekrutimit, përshkrimi i vendit të punës, kualifikimet e nevojshme, si edhe aftësitë specifike që duhet të ketë personeli dhe vullnetarët në marrëdhëniet me fëmijë dhe të	1.1 Ekzistojnë dokumente që tregojnë për strukturën e personelit dhe shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet tyre.

në grup, ashtu edhe individualisht, për realizimin e deklaratës së qëllimit. Programet janë të akredituara nga strukturat përkatëse përgjegjëse.	përkujdesje dhe shërbimet e nevojshme nga një staf kompetent. Çdo qendër ka një rregullore të brendshme, ku janë të përcaktuara rregullat e aktivitetit të përditshëm, detyrat dhe përgjegjësitë e stafit.	afërmit e tyre.	
		2. I gjithë personeli, duke përfshirë edhe drejtorin e institucionit, kanë përshkrimet e vendit të punës, ku deklarohen qartë përgjegjësitë, detyrat, si dhe varësia hierarkike.	2.1 Gjatë diskutimit personeli demonstron se njeh mirë dhe kupton udhëzuesin e sjelljes.
			2.2 Personeli i njeh mirë përshkrimet e punës, si edhe kupton se si përgjegjësitë që ka, kontribuojnë për mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve.
		3. Procedurat e punësimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi (Kodi i Punës)	3.1 Personeli emërohet sipas një procesi transparent. Kopje të lajmërimeve për vendin e punës si dhe të dhëna të regjistruara gjatë procesit të përzgjedhjes janë të disponueshme. Përzgjedhje e kujdesshme e personelit, jo vetëm kualifikim i duhur, por edhe balancë gjinore për t'iu përshtatur edhe numrit dhe gjinisë së fëmijëve.
			3.2 Çdo punonjës ka një kontratë pune të nënshkruar.
		4. Ofrohen programe trajnimi për personelin. Trajnimi i parë (trajnim induksioni) lidhur me vendin e punës ofrohet për personelin e ri brenda muajit të parë nga emërimi i tij.	4.1 Ekzistojnë paketa për trajnimin e induksionit për stafin e ri.
			4.2 Personeli ka dijeni për mundësitë për trajnim, si edhe inkurajohet që të marrë pjesë në këto trajnime.
			4.3 Për çdo person të personelit ka nga një vërtetim për çdo trajnim të kryer. Bëhet një identifikim periodik i nevojave për trajnim që ka secili.
		5. Sistemi i vlerësimit të performancës së stafit dhe i monitorimit të punës.	5.1 Ekzistojnë dhe zbatohen procedurat e vlerësimit të performancës dhe të monitorimit të punës së personelit.
			5.2 Ka dokumente që provojnë se vlerësimi dhe monitorimi kryhen sistematikisht.
			5.3 Personeli njeh të drejtat dhe detyrat funksionale, si dhe autoritetin që mbikëqyr cilësinë e punës.

KËRKESË
Nr. 734/6, datë 1.12.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim i bllokut të banesave të kufizuar nga bulevardi 'Çamëria', rruga 'Pelivan Leskaj', rruga 'Piro Sava' dhe rruga 'Kujtim Beqiri"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "truall" bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", ndërsa vlerësimi ndërtesës është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit "ndërtesë banimi ose jo banimi", i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 36,852,455.36 (tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIM I BLLOKUT TË BANESAVE TË KUFIZUAR NGA BULEVARDI 'ÇAMËRIA', RRUGA 'PELIVAN LESKAJ', RRUGA 'PIRO SAVA' DHE RRUGA 'KUJTIM BEQIRI'"

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Volum	faqe	Truall m²	Ndërtesë m²	Adresa	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe trualli	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime
1	8602	27/90-ND	9	64		50	Vlorë	Spiro Andon Trifoni	ndërtesë		10903	0	50	77514.2	3875710	3875710	C-Të drejtat reale ; nr. regj bosh, datë 1.8.2014, Shteti është pronar i pasurisë 27/40-T Vol. 9, faqe 57 mbi pasurinë 27/40-ND. D-Kufizimet e pronësisë: me nr. 00004255, datë 1.8.2014, në bazë të vërtetimit të faktit juridik nr. 384, Andon Trifoni posedon një pasuri
2	8602	27/90+1-2	6	79		70	Vlorë	Albana Piro Çela	apartament		10903	0	70	77514.2	5425994	5425994	
3	8602	27/28+1-1	8	72	0	56.8	Vlorë	Berta Meçani, Kastriot Meçani, Robert Meçani, Natasha Likaj, Suzana Meçani	apartament		10903	0	56.8	77514.2	4402806.56	4402806.56	
4	8602	27/28+1-3	8	74	34.4	56.8	Vlorë	Antoneta Haxhi Luloj	apartament	34.4	10903	375063.2	56.8	77514.2	4402806.56	4777869.76	Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 34.4 m² truall
5	8602	27/28+2-5	8	76	0	56.8	Vlorë	Andon Spiro Trifoni, Dhimitraq Andon Trifoni, Kristina Stefan Trifoni, Lorenc AndonTrifoni, Margarita AndonTrifoni,Spiro Andon Trifoni, Suzana Iliraq Trifoni	apartament		10903	0	56.8	77514.2	4402806.56	4402806.56	
6	8602	27/28+2-6	8	77	0	56.8	Vlorë	Aferdita Skenderi, Ali Haxhi Skenderi, Arjan Skenderi, Artur Skenderi	apartament		10903	0	56.8	77514.2	4402806.56	4402806.56	
7	8602	27/28+2-7	8	78	35.2	56.8	Vlorë	Albana Piro Çela	apartament	35.2	10903	383785.6	56.8	77514.2	4402806.56	4786592.16	Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 35.2 m² truall
8	8602	27/28+2-8	8	79	34.4	56.8	Vlorë	Tatjana Muharrem Hoxhaj	apartament	34.4	10903	375063.2	56.8	77514.2	4402806.56	4777869.76	Në bazë të formularit nr. 2 ka privatizuar edhe 34.4 m² truall
9	8602	27/90-T	9	57	50		Vlorë	SHTET	TRUALL	50		0	0	77514.2	0	0	
		Vlera paraprake e shpronësimit														**36852455.36**	

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 160
Datë: 2022/12/05 14:30:48
bb209803-0243-42b0-bf83-210e1d39b805

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë